

- [Lajmi](#)
- KosovaPress , 06 Maj 2016 08:26

## Sot fillon udhëtimi familjarizues për turizmin



Për herë të parë në Kosovë po organizohet udhëtimi familjarizues për operatorët turistikë ndërkombëtarë, si dhe për disa gazetarë me qëllim që të stimulohet turizmi dhe të krijohen kontakte në mes të bizneseve turistike vendore dhe atyre të huaja.

Në udhëtimin familjarizues do të marrin pjesë 25 persona nga e gjithë bota, të cilët do të njoftohen me Kosovën për së afërmi. Mbrëmë ata janë të ftuar të darkojnë me zyrtarë të Ministrisë të Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe përfaqësues të organizatave të tjera.

Kurse, sot do të vazhdojnë vizitën për në perëndim të Kosovës, më saktë në Bogë, Deçan, Junik e Gjakovë.

Të shtunën (7 maj) do ta vizitojnë Prizrenin, Brodin dhe Brezovicën. Të shtunën në mbrëmje do të jenë në Prishtinë në kuadër të mbrëmjes solemne, ku do të kenë mundësi të takohen me rreth 100 biznese vendore të fushës së turizmit./KosovaPress/

Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KosovaPress-COPYRIGHT 2002-2016

Ndalohet rreptësisht marrja dhe shpërndarja ne media, portale... pa autorizim paraprak me shkrim nga A.P.L. KosovaPress.

Kontakt:

Redaksia: info@kosovapress.com, tel: +37744507766, +38138249721

Parapagimi: parapagimi@kosovapress.com.

Konkurset: konkurs@kosovapress.com

- See more at: <http://www.kosovapress.com/sq/nacionale/sot-fillon-udhetimi-familjarizues-per-turizmin-72082/#sthash.XpH8KYCf.dpuf>